

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                        |
|---------|--------------------------------------------------------|
| TITULLI | Historia veç me tri shkronja                           |
| ADRESA  | https://lapsi.al/historia-vec-me-tri-shkronja-i1093604 |
| BURIMI  | lapsi.al                                               |
| GJENDJA | online                                                 |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 13 shtator 2026, 11:12:36 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 11:09:36 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 7df3716ee421733800266f66e40e2efcb323ef1318de0eb27ffb3cba17cf5657 |
| TEKSTI     | ed00b41ce1386759a789d79b6fa1608bd5020019b24323e0a14da3d33a5389aa |
| PAMJA      | 59e290dfef66eacf8d32af4ef7b0d3bb140bee6d7353ef747ad8e1dc5cc9da45 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 321675a63ac6e200eaaa7fb0cefd01026ded94c7f245220c5d473a596915a63f                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 0af30820f7b02459c7b64c12b5c786d395234e674e10dcca03a9dded8bb3261e                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/321675a63ac6e200eaaa7fb0cefd01026ded94c7f245220c5d473a596915a63f>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



# Historia veç me tri shkronja



MIRJON BRAHIMLLARI • 13 SEPTEMBER 2026



Atje, në Hagë, pritet vendimi gjyqësor për katër Çlirimtarët. Këtu, në Shqipëri, një popull i tërë, nuk pret thjesht një vendim gjykate, nuk pret thjesht liri për çlirimtarët e tij, por pret të shohë nëse historia e tij do të trajtohet me drejtësi. A mund të ndahet drejtësia nga historia? Kjo është një dilemë e madhe, aq e madhe sa duket ka zënë ngusht edhe vetë Gjykatën Speciale. Siklet që lehtësisht kuptohet nga ky gjykim i stërzgatur disa vjeçar, si dhe nga pothuaj 6 vite paraburgim të 4 liderëve politikë, të shtetit më të ri të Europës.

Në fakt, si mund të mos zgjaste e stërzgjaste një proces i tillë, ku vetë procesi, në krye të herës, u ngjiz nga përralla me shtëpi të verdha, të prodhuara nga përrallaxhinjtë me të mëdhenj të Europës moderne, Carla del Ponte dhe Dick Marti, një dyshe të cilën, për nivelin e shfrenuar të fantazisë, do ta kishin zili edhe Vëllezërit Grim.

Gjyqtarët, në këto 3 vite proces, mijëra faqe dokumentesh e qindra dëshmitarë të thirrur në sallën e gjyqit, doemos e kanë kuptuar tashmë se UÇK-ja nuk lindi nga hiçi, por lindi në një Kosovë ku gjenocidi, dhuna dhe shkelja e të drejtave themelore nuk kishin lënë alternativë tjetër. Për shqiptarët e Kosovës, lufta nuk ishte zgjedhje, por ballafaqim me realitetin që kishte ardhur deri në kufijtë e ekzistencës.

Kjo nuk do të thotë se çdo veprim i kryer gjatë luftës duhet të justifikohet. Asnjë flamur, asnjë uniformë, asnjë komandë dhe asnjë kauzë nuk e vendos njeriun mbi ligjin. Nëse një individ ka kryer krime, ai duhet të përgjigjet për to. Nëse provat nuk mjaftojnë për të provuar fajësinë, atëherë drejtësia duhet të ketë kurajën ta thotë edhe këtë.

Por ka rrezik që një gjykim individual të shndërrohet në një gjykim moral të të gjithë luftës së Kosovës. Kjo nuk duhet të ndodhë. Sepse një vendim gjykate nuk mundet dot të ndryshojë faktin historik se Kosova ishte nën gjenocid dhe se lufta e UÇK-së u zhvillua në rrethanat e një konflikti të armatosur që solli ndërhyrjen ndërkombëtare dhe përfundimisht çlirimin e Kosovës. Mund të gjykohen krime, mund të dënohen individë, por nuk mund të dënohet një popull pse luftoi për liri. Lufta e Kosovës për liri është historia e mijëra njerëzve që morën armët, e familjeve që humbën njerëzit e tyre, e të dëbuarve, e dëshmorëve, e të zhdukurve, e të rinjve që u nisën drejt fronteve pa ditur asgjë për të kaluarin dhe asnjë shprehje që kërkonte të drejtën e një tjeturi liri.

## ide



Ortaku besprerë i Ron Yeffetit  
Andi Bushati



Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet  
Blendi Kajsiu

MOTITIRANA

28°C

KËMBIMIEURO

91.94

## aktuale

09:18

**Dita e 106-të e protestës, diaspora zbret sërish në shesh, paralajmërohet revoltë masive**

08:44



Protesta qytetare në Tiranë/  
Associated Press: Lëvizje më e gjerë antiqeveritare, që kërkon dorëheqjen e Edi Ramës



**TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë**

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



shpallje të kësaj lloji, dhe një shprehje që kërkon të arrijen për të jetuar e mirë.

Pritja për shpalljen e vendimit të Speciales, nuk e di pse më sjell ndër mend vargjet e një kënge shumë adekuate për kohën në të cilën po jetojmë.

*...Kujtoj tri shkronjat që na sollën festën,  
kujtoj torturat, masakrën, protestën,  
e mos thoni UÇK-ja ka bërë krime nëpër shkije,  
se na kem luftu n'Kosovë e jo midis Serbie.  
Thuj ç'ka t'dush nëse paske ç'ka me thanë,  
veç jo për UÇK-në deri në qershor 99...*

E vërteta është se nuk mund të kriminalizohet një aspiratë kombëtare sepse në një luftë mund të jenë kryer edhe veprime të paligjshme nga individë. Historia e një populli nuk mund të vendoset në bankën e të akuzuarve bashkë me katër njerëz. Dhe për ironi të fatit, historia përsërit herë pas here veten, sikur të dojë të tregojë me forcë e kryeneçësi, që ajo nuk duhet të harrohet kurrë nga popujt.

Një shekull më parë (maj 1881) Abdyl Frashëri dhe Sulejman Vokshi, liderët politikë dhe ushtarakë të Lidhjes së Prizrenit, gjendeshin në burgjet e Turqisë, të akuzuar nga Perandoria Osmane se kishin kryer krime gjatë luftës për liri të popullit të tyre. Në dramën Epoka para gjyqit të Ekrem Kryeziut, është lapidare përgjigjja që Abdyl Frashëri i kthen kryetarit të trupit gjykues kur e pyet se përse mori pjesë në luftën për liri të popullit të tij... Që në fillim ju them, unë nuk mund të përgjigjem vetëm në emrin tim. Jam shumë i vogël në krahasim me popullin, të cilin nuk mund ta thërrisni në gjykim e ta dënoni ashtu si do të më dënoni mua. Unë nuk kam bërë asgjë tjetër, por si bir i mirë, kam ndjekur mendimin e tij...


Liderët e Lidhjes së Prizrenit u ulën në bankën e të akuzuarve të Perandorisë Osmane. Një shekull më vonë, në një tjetër sallë gjyqi, historia e Kosovës përsëri pret vendimin për njerëzit që e shkruan atë me luftë.

Ajo që duhet të ndodhë është se, nga njëra anë, Gjykata duhet të gjykojë njerëz konkretë, mbi prova konkrete dhe për përgjegjësi konkrete. Ajo nuk mund të zëvendësojë historianin dhe, aq më pak, nuk mund të japë një verdikt mbi një popull të tërë.

Nga ana tjetër, si do që të jetë ai, Kosova duhet ta presë vendimin e Hagës me dinjitet. 16 shtatori nuk duhet të jetë dita kur Kosova i kthen shpinën drejtësisë. Duhet të jetë dita kur Kosova i kërkon drejtësisë të mos i kthejë shpinën historisë.

Lufta për liri nuk e bën askënd automatikisht të pafajshëm. Por as një aktakuzë nuk e bën askënd automatikisht fajtor. Kjo është arsyeja pse, meqenëse erdhi puna deri këtu, Çlirimtarët duhet të gjykojnë nga Specialja mbi prova dhe fakte, ndërsa UÇK-ja mund dhe duhet të gjykohet vetëm nga historia.

Dhe historia e Kosovës është shumë më e madhe se një sallë gjyqi në Hagë.



**Gjyqtari i GJKKO: Rama mund të ketë përgjegjësi penale për mosekzekutimin e vendimit të pagave të magjistratëve**



Kartoni i zi mbërrin në futboll, ja si funksionon: nuk do të përdoret për futbollistët



Qarkullonte me armë, arrestohet nipi i Lefter Kokës



E bujshme, Arteta e ka sabotuar qëllimisht Arsenal, duke shkaktuar edhe vonesa në fluturime: në Napoli funksionoi

## Të këshilluara



### E respektoj Izraelin, por Labërinë e dua më shumë

Shpesh Shqipëria bëhet shesh beteje për një ndërtesë dhe, në fund, përfundojmë duke debatuar për historinë. Debat i sotëm për godinen ku është themeluar Klubi Labëria është njëri prej tyre.



### Është krizë përfaqësimi jo informimi

Deputetët socialistë takohen me qytetarin vetëm kur ia kërkon Rama, sepse atë përfaqësojnë dhe atij i binden. Ndaj takimi i tyre me qytetarët nuk bëhet për të qarë hallin qytetar, por për të zgjidhur hallin e Ramës me pakënaqësinë e qytetare



## Mbi 1,660 produkte me çmime më të ulëta nga e hëna



## Nga Vlora te Ceuta: a ka harruar Evropa se "ata janë njerëz"?

Evropa përjetoi një nga imazhet më të jashtëzakonshme në historinë e saj të fundit të migrimit 35 vjet më par...



## Rama të shpjegojë pse shpall non grata shqiptarët e Kosovës dhe Maqedonisë

Në 25 shkurt të vitit 2017, Mitropoliti i Malit të Zi Amofilohije Radoviq, erdhi në Shkodër dhe deklaroi se Mali i Zi nuk e ka sulmuar...



## Në mënyrë të pashërueshme të korruptuar!

Projekti të cilën përfituesi i vetëm i saj, investitori e konsideron "të ndërtuar gabimisht shpejt" mbështetet në një shum...



## Imuniteti i drejtuesve të BSH nuk është kërkesë e BE



Roma mund të fusë Shqipërinë në forën e



## Rama munda ta ruse Shqipërinë në fazën e "jostabilitetit të menaxhuar"

1. Kryeministri Rama mbledhi javën e kaluar udhëheqjen socialiste dhe ua paraqiti një platformë për qeverisje në mandatin e katërt...



## Profesori i antropologjisë demonton platformën e Ramës/ 'Besa', ose kur fjalën e vret folësi!

Rama e paraqet 'Besën' si kthesë. Kthesë prej kujt? Kthesë nga ku?



## Nga Tiki-Taka te Telco: Pas Botërorit, Europa duhet të fitojë sfidën dixhitale

Personalisht e kam dashur futbollin spanjoll që nga koha e Barçës së Guardiola's, dhe gjithashtu punoj në telekomunikacion. Pra po, ky shkrim është i njëanshëm nëse je tifoz me një skuadër tjetër.

## Me sytë katër



11:43

## Pamje të rënda/ Avokati amerikan i drejton armën ish-gruas së tij në restorant

Matthew Exton, një ish-avokat 43-vjeçar dhe ish-prokuror lokal në Ohajo, u shpall fajtor për tentativën e vrasjes së ish-gruas ...



## PAMJET/ Shoferi ishte pa ndjenja, polici jashtë detyrës ndalon makinën

11:17



## A po eksporton apo jo armë Shqipëria? Ministria e Mbrojtjes me dy versione (VIDEO)

16:47



## "Plaka ime s'di pultin e TV dhe jo më e-Albania"/ Korreshi tallet në Komisionin e Ligjeve

21:56



## VIDEO/ Batutat e Ramës me Altinin nga Peza: Ky nuk është socialist, por...

23:04

## SPORT

→ Të tjerë artikuj



## Tenistja ukrainase, Yastremska rrëfen e tronditur: "Një raketë ruse ma shkatërroi shtëpinë"



## Mammana përplaset nga portieri: brinjë të thyera dhe mushkëri e shpuar, operohet me urgjencë



## Gafa skandaloze e Estupiñán dhe përplasja e De Winter me Gila: mbrojtja e Amoris turpshme



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.